


**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË EKSPLOATIMIT TË
BAZALTEVE, NGA KOMPANIA “Karakushi” SH.P.K.,
ZHUB KOMUNA E GJAKOVËS**



INVESTITORI
“Karakushi” SH.P.K.
Zhub, Gjakovë

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR ZGJERIMIN E ZONËS
SË EKSPLLOATIMIT TË BAZALTEVE, NGA KOMPANIA “Karakushi” SH.P.K.,
ZHUB KOMUNA E GJAKOVËS**

Ngastra me nr. P-70705033-00426-0, Zona kadastrale Zhub, Komuna e Gjakovë.

INVESTITORI	
Aplikuesi	Mehmet Karakushi
Investitori	“Karakushi” SH.P.K.
Adresa:	Fshati Raçë, Komuna e Gjakovës
Lokacioni i Fabrikës	Zhub, Komuna e Gjakovës
Tel:	+383 44 246 299
Email:	Karakushi.shpk@hotmail.com

Investitori:

“Karakushi” SH.P.K.

Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Blerinabajraktari1@gmail.com

+383 49 588 634

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE.....	1
2.	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR.....	2
2.1.	Kategoria e Projektit të Propozuar.....	2
2.2.	Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit.....	2
2.3.	Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit.....	3
2.4.	Përshkrimi detal i procesit të planifikimit të prodhimit, duke filluar nga hyrja e lëndëve të para deri te produkti përfundimtar.....	3
2.5.	Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme	4
2.6.	Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik.....	5
2.7.	Prezantimi i teknologjisë së trajtimi, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave.....	5
2.8.	Programi për ndërtimin, kohëzgjatja e ndërtimit, kohëzgjatja e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit	5
2.9.	Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme	6
2.10.	Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave.....	6
2.11.	Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin.....	7
2.12.	Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese	7
3.	PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR.....	8
3.1.	Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti.....	8
3.2.	Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit	8
3.3.	Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti.....	10
3.4.	Paraqitje e karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit.....	10
3.5.	Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë.....	11
3.6.	Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik.....	11
3.7.	Prezantimi i karakteristikat natyrore.....	12
3.8.	Rishikimi i karakteristikat themelore të peizazhit.....	12
3.9.	Rishikimi i objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike	12
3.10.	Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar	12
3.11.	Të dhëna për objektet ekzistuese.....	13

3.12.	Në varësi të karakteristikave të zonës, përshkrimi i lokacionit përmban edhe të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkelogjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme.....	13
3.13.	Të dhënat për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dh në afësi të saj	13
4.	GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR.....	14
4.1.	Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor.....	14
5.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT	15
5.1.	Përshkrimi i alternativave të realizueshme.....	15
5.2.	Përshkrimi i alternativave të realizueshme përmban edhe përshkrimin e arsyeve kryesore për zgjedhjen e një alternative të caktuar duke ju referuar:	15
5.3.	Vendndodhja ose rruga.....	16
5.4.	Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut	16
5.5.	Proceset dhe teknologjia e prodhimit.....	17
5.6.	Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit.....	17
5.7.	Plani i lokacionit.....	18
5.8.	Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit.....	18
5.9.	Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit	19
5.10.	Madhësia e lokacionit ose objektit	19
5.11.	Vëllimi i prodhimit.....	19
5.12.	Kontrolli i ndotjes.....	19
5.13.	Trajtimin e mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar	20
5.14.	Rregulimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacionit	20
5.15.	Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit.....	20
5.16.	Trajnimi.....	21
5.17.	Monitorimi.....	21
5.18.	Planet për situata emergjente	21
5.19.	Demolimi dhe rehabilitimi.....	21
5.20.	Plani për menaxhimin e mjedisit.....	21
5.21.	Përshkrimi i alternativës pa veprim	21
6.	PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS	22
6.1.	Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përfshinë.....	22
6.2.	Cilësinë e ajrit	22
6.3.	Niveli dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi:.....	22

6.4.	Ndikimin e projektit në klimë, lloji dhe vëllimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike:.....	23
6.5.	Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit:.....	23
6.6.	Cilësia e ujit.....	23
6.7.	Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	24
6.8.	Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave	24
6.9.	Ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia me referencë të veçantë për shkarkimet e ujërave të zeza.....	24
6.10.	Toka	24
6.11.	Ndikimi fizik, ndryshimi në topografinë lokale, erozioni i tokës, rrëshqitjet e tokës, etj. ...	25
6.12.	Ndikimi i emetimeve të ndotësve në vendndodhjen e projektit të planifikuar dhe në tokën përreth dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standarde sipas legjislacionit përkatës	25
6.13.	Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore	25
6.14.	Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur	26
6.15.	Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike	26
6.16.	Popullsia lokale	26
6.17.	Ndryshimet në numrin dhe strukturën e popullsisë dhe ndikimet të lidhura me mjedisin, popullsinë, përqendrimi dhe migrimi.....	27
6.18.	Ndikimet vizuale të vendbanimeve	27
6.19.	Ndikimet e emetimit të ndotësve, zhurmës, vibrimet, nxehtësisë dhe të gjitha llojet e rrezatimit në shëndetin e njeriut.....	27
6.20.	Ndikimet socio-ekonomike.....	27
6.21.	Ndikimi i projektit në strukturën e ekonomisë lokale, sipas sektorit prodhues dhe degës kryesore të zonës	28
6.22.	Numri i vendeve të punës të krijuara gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit, si dhe humbjet e mundshme të vendeve të punës në sektorët apo zonat e prekura	28
6.23.	Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare	28
6.24.	Ekosistemet dhe gjeologjia.....	29
6.25.	Humbja dhe dëmtimi i specieve bimore dhe shtazore dhe habitateve të tyre.....	29
6.26.	Humbja dhe dëmtimi i veçorive gjeologjike, paleontologjike dhe gjeomorfologjike, biodiversitetit, florës dhe faunës, pasurive natyrore të mbrojtura, specieve të rralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe kafshëve të egra dhe habitateve të tyre.....	29
6.27.	Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve.....	30
6.28.	Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara	30
6.29.	Shfrytëzimi i tokës.....	30
6.30.	Infrastruktura komunale	30

6.31.	Trafiku.....	31
6.32.	Furnizimi me ujë	31
6.33.	Energjia	31
6.34.	Ujërat e zeza	31
6.35.	Gjenerimi i mbeturinave.....	31
6.36.	Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit	32
6.37.	Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përmban gjithashtu informacione që rezultojnë nga	32
6.38.	Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit	32
6.39.	Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese	32
6.40.	Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis	33
6.41.	Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit.....	33
6.42.	Emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit	33
6.43.	Emetimet në ajër të gazeve serrë gjatë operimit	33
6.44.	Ndikimet në ndryshimet klimatike	33
7.	PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS.....	34
7.1.	Masat e parashikuara me legjislacion	34
7.2.	Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha	34
7.3.	Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit.....	34
7.4.	Masat të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e efekteve të dëmshme në mjedis.....	35
8.	PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS	36
8.1.	Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis.....	36
8.2.	Prezantimin e gjendjes mjedisore përpara se projekti të vihet në punë ose fillimi i aktiviteteve në vendet ku ndikimi mjedisor pritet.....	36
8.3.	Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis	36
8.4.	Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar.....	37
8.5.	Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera.....	37
8.6.	Detyrimi për të informuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera.....	37
8.7.	Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis.....	38
9.	PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR.....	39
9.1.	Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit.....	39
9.2.	Pajtushmeria me pëlqim mjedisor	39
9.3.	Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000	39

10. INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT	40
10.1. Informacionet dhe karakteristikat shtesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së,.....	40
10.2. Baza ligjore dhe rregullative.....	40
10.3. Dokumentacioni teknik	41
11. BURIMET E TË DHËNAVE.....	42
11.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së.....	42
12. SHTOJCA.....	42
13. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E INFORMACIONIT	43
13.1. Hyrje	43
13.2. Përshkrimi i Projektit.....	43
13.3. Ndikimet kryesore mjedisore dhe masat mbrojtëse.....	43
13.4. Përfitimet socio-ekonomike.....	44
13.5. Përfundimi.....	45

Lista e Figurave

Figura 1. Distanca me biznese tjera	7
Figura 2. Shtrirja hapësinore e Lokacionit të projektit në territorin e Komunës së Gjakovës ...	9
Figura 3. Distanca e kompanisë me qytetin e Gjakovës	9
Figura 4. Distanca e Kompanisë nga Shtëpi Banimi	10

Lista e Tabelave

Table 1. Koordinata e Zonës së Zgjeruar	8
---	---

1. HYRJE

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është përgatitur për projektin e zgjerimit të zonës së eksploatimit të bazalteve nga kompania “Karakushi” SH.P.K., në fshatin Zhub, Komuna e Gjakovës. Qëllimi i këtij raporti është të identifikojë dhe të vlerësojë ndikimet e mundshme në mjedis që mund të rezultojnë nga zgjerimi i aktivitetit ekzistues të eksploatimit të bazalteve, si dhe të propozojë masa konkrete për parandalimin, zvogëlimin dhe menaxhimin e këtyre ndikimeve. Zgjerimi i zonës së eksploatimit paraqet vazhdim të aktivitetit minerar të kompanisë, me qëllim rritjen e kapacitetit prodhues dhe sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me material bazaltik për nevojat e tregut. Aktiviteti do të realizohet në përputhje me kushtet teknike, standardet mjedisore dhe kërkesat ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës. Raporti është hartuar në përputhje me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 dhe aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë procedurën e VNM-së. Në kuadër të analizës janë trajtuar komponentët kryesorë mjedisorë, përfshirë tokën, ajrin, ujin, biodiversitetin, peizazhin, zhurmën, vibrimet si dhe aspektet socio-ekonomike. Ky dokument do të shërbejë si bazë për vendimmarrje nga autoritetet kompetente lidhur me pajisjen e projektit me pëlqim mjedisor dhe përcaktimin e kushteve për zhvillimin e aktivitetit në mënyrë të kontrolluar dhe të qëndrueshme.

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

2.1. Kategoria e Projektit të Propozuar

Projekti i propozuar për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga kompania “Karakushi” SH.P.K., në fshatin Zhub, Komuna e Gjakovës, i takon kategorisë së projekteve minerare për eksploatim sipërfaqësor të materialeve ndërtimore. Në këtë fazë, aktiviteti nuk përfshin proces teknologjik të përpunimit apo trajtimit industrial të materialit në lokacion. Aktiviteti përbëhet vetëm nga procesi i punës, i cili zhvillohet në këto etapa Minimi i masës shkëmbore të bazaltit, mbushja e materialit në kamionë me ekskavator dhe dërgimi i bazaltit deri tek vendi i destinimit. Projekti, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, i nënshtrohet procedurës së VNM-së për shkak të natyrës minerare të aktivitetit dhe potencialit për ndikime në mjedis. Ndikimet e mundshme lidhen kryesisht me ndryshimin e konfiguracionit të terrenit, degradimin e tokës, gjenerimin e pluhurit gjatë minimit dhe transportit, si dhe zhurmën dhe vibrimet nga përdorimi i makinerive dhe shpërthimeve të kontrolluara. Duke marrë parasysh shtrirjen e zgjerimit dhe karakterin e aktivitetit, projekti konsiderohet me ndikim potencial mjedisor gjatë fazës së operimit, por këto ndikime janë të menaxhueshme përmes masave të përcaktuara në këtë raport.

2.2. Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit

Meqenëse aktiviteti ekzistues i eksploatimit është në zhvillim, punët përgatitore për zgjerimin e zonës së eksploatimit fokusohen në përgatitjen e sipërfaqes së re të planifikuar për minimin. Punët përgatitore përfshijnë:

- Pastrimin e sipërfaqes nga vegetacioni dhe materialet e papërshtatshme;
- Heqjen dhe zhvendosjen e shtresës së tokës humusore, me qëllim ruajtjen e saj për rehabilitim të mëvonshëm;
- Stabilizimin dhe rregullimin e terrenit për krijimin e kushteve të sigurta të punës;
- Hapjen dhe sistemimin e rrugëve të brendshme për qarkullimin e makinerive dhe kamionëve;
- Përcaktimin e zonave të sigurta për operacionet e minimit dhe për lëvizjen e mjeteve të punës.

Punët përgatitore kanë karakter terreni dhe organizativ, me qëllim krijimin e kushteve teknike për zhvillimin e procesit të minimit, mbushjes së materialit në kamionë dhe transportit të tij drejt destinacionit. Të gjitha këto aktivitete do të realizohen duke respektuar masat e sigurisë teknike dhe mjedisore, me qëllim minimizimin e ndikimeve në tokë, ajër dhe mjedisin përreth.

2.3.Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit

Funksionimi i projektit për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga “Karakushi” SH.P.K. bazohet në operacione minerare sipërfaqësore, pa përfshirë procese të përpunimit industrial në lokacion. Aktiviteti zhvillohet përmes një procesi të thjeshtë pune, i cili përfshin:

- Minimimi i masës shkëmbore të bazaltit përmes minimeve të kontrolluara;
- Ngarkimin e materialit të nxjerrë me ekskavator në kamionë transportues;
- Transportimin e bazaltit drejt destinacionit të përcaktuar.

Operimi realizohet me përdorimin e makinerive të rënda minerare, mjete për vendosjen e eksplozivit, ekskavatorë dhe kamionë transportues. Aktiviteti zhvillohet në nivele të planifikuara të eksploatimit, në përputhje me projektin mineral dhe me kushtet e sigurisë teknike. Funksionimi i projektit karakterizohet nga ndikime tipike për aktivitete minerare sipërfaqësore, si gjenerimi i pluhurit gjatë minimit dhe transportit, zhurma dhe vibrimet nga shpërthimet dhe makineritë, si dhe ndryshimi progresiv i konfiguracionit të terrenit. Operimi do të organizohet në mënyrë të kontrolluar, me zbatim të masave për siguri teknike dhe mbrojtje mjedisore, si dhe me planifikim për rehabilitim progresiv të zonës së eksploatuar.

2.4.Përshkrimi detaj i procesit të planifikimit të prodhimit, duke filluar nga hyrja e lëndëve të para deri te produkti përfundimtar

Në kuadër të projektit për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga “Karakushi” SH.P.K., procesi i prodhimit nuk përfshin përpunim industrial në lokacion. Aktiviteti përbëhet vetëm nga operacione minerare të nxjerrjes dhe transportit të materialit. Procesi zhvillohet në këto faza kryesore:

- **Minimi i masës shkëmbore** - Minimi realizohet në mënyrë sipërfaqësore, sipas planit mineral të miratuar. Procesi përfshin shpimin e vrimave në masën shkëmbore dhe realizimin e shpërthimeve të kontrolluara për fragmentimin e bazaltit. Shpërthimet kryhen në përputhje me parametrat teknikë të sigurisë, duke respektuar distancat mbrojtëse dhe masat për kontrollimin e vibrimeve dhe pluhurit.
- **Mbushja e materialit në kamionë** - Pas fragmentimit, materiali i nxjerrë ngarkohet me ekskavator në kamionë transportues. Gjatë kësaj faze sigurohet stabiliteti i frontit të punës dhe organizimi i lëvizjes së makinerive brenda zonës së eksploatimit. Operacioni zhvillohet në mënyrë të kontrolluar për të shmangur rreziqet teknike dhe për të reduktuar ngritjen e pluhurit.

- **Transportimi i bazaltit** - Materiali i nxjerrë transportohet me kamionë deri tek vendi i destinuar për thërrmim, i cili ndodhet ne parcelen e njejt, dhe eshte ne zoterim te kompanisë “Karakushi”.

Planifikimi i këtij procesi bëhet në baza vjetore dhe mujore, në përputhje me kapacitetin e miratuar të nxjerrjes dhe kërkesën e tregut. Operacionet organizohen në mënyrë progresive, duke respektuar stabilitetin e skarpave, menaxhimin e sipërfaqes së punës dhe masat e sigurisë teknike. Ky model operimi paraqet një proces të thjeshtë minerar, me ndikime tipike që lidhen me ndryshimin e relievit, gjenerimin e pluhurit, zhurmën dhe vibrimet, të cilat trajtohen përmes masave të parashikuara në këtë raport.

2.5.Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme

Për realizimin e projektit për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga “Karakushi” SH.P.K., nevojiten burime materiale dhe njerëzore që lidhen drejtpërdrejt me procesin e minimit dhe transportit të materialit.

- **Burimi minerar** - Burimi kryesor është masa shkëmbore e bazaltit brenda zonës së zgjerimit, e cila do të eksploatohet sipas planit minerar dhe rezervave të miratuara.
- **Karburanti** - Makineritë e përdorura në proces, përfshirë pajisjet për shpim, ekskavatorët dhe kamionët transportues, funksionojnë me naftë. Konsumi i karburantit varet nga dinamika e punës dhe kapaciteti i planifikuar i nxjerrjes. Karburanti përbën burimin kryesor energjetik për funksionimin e projektit.
- **Eksplozivi dhe mjetet plasëse** - Procesi i minimit realizohet përmes shpërthimeve të kontrolluara. Për këtë qëllim përdoren mjete plasëse. Sasia e eksplozivit përcaktohet në përputhje me vëllimin e planifikuar për nxjerrje dhe karakteristikat gjeologjike të terrenit.
- **Makineritë dhe pajisjet** - Për zhvillimin e aktivitetit përdoren pajisje për shpim, ekskavatorë për ngarkim dhe kamionë për transport. Këto mjete janë të domosdoshme për realizimin e procesit të minimit dhe dërgimit të materialit drejt vendit të thërrmimit.
- **Burimet njerëzore** - Projekti realizohet nga personeli i trajnuar dhe i licencuar për operacione minerare, përfshirë minatorë, operatorë të makinerive dhe staf teknik mbikëqyrës.

2.6.Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik

Në kuadër të projektit për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga “Karakushi” SH.P.K., ku aktiviteti përfshin vetëm minimin, mbushjen e materialit në kamion dhe transportin e tij. Gjatë këtij procesi nuk gjenerohen mbeturina industriale apo mbetje nga përpunimi, pasi në lokacion nuk zhvillohet proces teknologjik. Mbeturinat e vetme që gjenerohen janë mbeturina komunale, të krijuara nga personeli gjatë qëndrimit në vendpunishte. Këto përfshijnë mbetje të zakonshme si ambalazhe ushqimore, shishe plastike dhe mbetje të tjera të ngjashme. Sasia e mbeturinave komunale është e vogël dhe varet nga numri i punëtorëve dhe kohëzgjatja e operimit ditor. Këto mbeturina grumbullohen në kontejnerë të përshtatshëm dhe largohen përmes sistemit komunal të menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me rregullat dhe kërkesat ligjore në fuqi.

2.7.Prezantimi i teknologjisë së trajtimit, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave

Gjatë zgjerimit të zonës së eksploatimit dhe operimit nuk do të bëhet trajtimi, përpunimi, riciklimi dhe asgjësim i mbeturinave. Mbeturinat komunale që krijohen nga aktivitetet e personelit grumbullohen veçmas dhe merren nga kompania e kontraktuar për grumbullimin e mbeturinave nga Komuna.

2.8.Programi për ndërtimin, kohëzgjatja e ndërtimit, kohëzgjatja e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit

Projekti për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga “Karakushi” SH.P.K. nuk përfshin fazë ndërtimi në kuptimin klasik të objekteve industriale. Faza fillestare përbëhet nga punët përgatitore në terren, të cilat realizohen brenda një periudhe të shkurtër kohore, në varësi të sipërfaqes së zgjerimit dhe kushteve në terren.

- **Faza e punëve përgatitore** - Kjo fazë përfshin pastrimin e sipërfaqes, largimin e shtresës së sipërme të tokës dhe organizimin e rrugëve të brendshme të qarkullimit. Kohëzgjatja e kësaj faze parashihet të jetë disa javë deri në disa muaj, varësisht nga dinamika e punës.
- **Faza e operimit** - Faza e operimit përfshin minimin e bazaltit, mbushjen në kamion dhe transportin drejt vendit të thërrmimit. Operimi zhvillohet në mënyrë progresive, sipas planit minerar dhe kapacitetit të miratuar të nxjerrjes. Kohëzgjatja e aktivitetit

varet nga rezervat minerare dhe lejet përkatëse, dhe mund të shtrihet në disa vite, deri në shfrytëzimin e plotë të zonës së planifikuar.

- **Faza e rehabilitimit** - Pas përfundimit të eksploatimit në një pjesë të caktuar të zonës, do të realizohet rehabilitimi progresiv i sipërfaqes së shfrytëzuar. Rehabilitimi përfshin:
 - Riformësimin e terrenit dhe stabilizimin e skarpave;
 - Shpërndarjen e shtresës së ruajtur të humusit;
 - Rikultivimin e sipërfaqes me mbjellje të përshtatshme sipas kushteve lokale.

Rehabilitimi do të realizohet në përputhje me planin e mbylljes së minierës dhe me kërkesat e autoriteteve kompetente, me qëllim rikthimin e zonës në një gjendje të qëndrueshme dhe të sigurt për mjedisin përreth.

2.9.Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme

Për realizimin e projektit për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga “Karakushi” SH.P.K., nevojitet infrastrukturë bazë që lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e procesit të minimit dhe transportit të materialit. Brenda zonës së eksploatimit parashihen rrugë të brendshme për lëvizjen e ekskavatorëve dhe kamionëve transportues. Këto rrugë do të sistemohen dhe mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar qarkullim të sigurt dhe efikas. Zona e eksploatimit ka qasje në rrugën ekzistuese, e cila mundëson lidhjen me rrjetin rrugor lokal dhe transportin e materialit drejt vendit të thërrmimit. Brenda sipërfaqes së zgjerimit do të përcaktohen frontet e minimit, hapësirat për manovrim të makinerive dhe zona të përkohshme për parkimin e pajisjeve. Makineritë furnizohen me naftë sipas nevojës operative, përmes mënyrës së organizuar nga kompania, në përputhje me rregullat e sigurisë.

Projekti nuk kërkon instalim të infrastrukturës për furnizim me ujë industrial, kanalizim apo energji elektrike, pasi në lokacion nuk realizohet proces përpunimi.

2.10.Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave

Në kuadër të projektit për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga “Karakushi” SH.P.K., nuk parashihet ndërtimi i kampeve, rezidencave apo objekteve të përhershme për akomodim të punëtorëve. Aktiviteti zhvillohet në kushte të hapura minerare dhe operimi realizohet nga personel që angazhohet në baza ditore. Punëtorët nuk qëndrojnë në lokacion jashtë orarit të punës dhe nuk ka nevojë për infrastrukturë banimi apo struktura të përkohshme rezidenciale.

2.11. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin

Pë zgjerimi i zonë së eksploatimit të bazaltëve investitori është i obliguar të pajiset me lejet dhe autorizimet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Lejet dhe licencat kryesore që kërkohen për zbatimin e projektit përfshijnë:

1. **Pëlqimi komunal** nga Komuna e Gjakovës për aktivitetin/lokacionin, sipas kompetencave komunale.
2. **Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM)** dhe vendimi për VNM nga MMPHI.
3. **Licenca nga KPM**
4. **Leja Mjedisore** nga MMPHI për operimin e aktivitetit.

Kompania tashme i ka të gjitha lejet, por pasi që ky raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis është duke u bërë për shkak të rritjes së kapaciteti të prodhimit. Të gjitha lejet dhe licencat do të respektohen gjatë gjithë ciklit të operimit, duke garantuar funksionim të rregullt dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

2.12. Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese

Në këtë zonë nuk ka zhvillim të aktiviteteve të tjera, prandaj ndërlidhja e këtij projekti është kryesisht me zonën e thërmimit, e cila është pjesë integrale e kompanisë, e cila ndodhet në një distancë prej rreth 133.07 metra . Ndërkohë, mund të ketë ndërlidhje me kompanitë e ndërtimit që përdorin bazaltin si material të papërpunuar për nevojat e tyre ndërtimore.



Figura 1. Distanca me biznese tjera

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

3.1. Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti

Projekti për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga kompania “Karakushi” SH.P.K. është në fshatin Zhub, Komuna e Gjakovës. Zona e projektit përfshin parcelën me numër kadastral P-70705033-00426-0, e regjistruar në sistemin kadastral të Republikës së Kosovës dhe që gjendet brenda territorit administrativ të Komunës së Gjakovës. Sipas dokumentacionit institucional përkatës, sipërfaqja është dhënë në shfrytëzim të përkohshëm për aktivitet minerar nga Agjencia e Pyjeve e Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në përputhje me kushtet dhe pëlqimet e lëshuara nga autoritetet kompetente. Kufijtë e sipërfaqes së projektit për shfrytëzim janë të përcaktuar sipas koordinatave zyrtaresi nga Agjencia e Pyjeve e Kosovës më poshtë:

Table 1. Koordinata e Zonës së Zgjeruar

Nr. i pikës	X (m)	Y (m)
1	7450788.879	4687424.791
2	7450571.726	4687490.149
3	7450439.027	4687499.112
4	7450390.210	4687636.342
5	7450485.346	4687670.144
6	7450657.982	4687641.750
7	7450776.750	4687551.004
8	7450772.276	4687524.693

3.2. Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit

Vendndodhja e projektit për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga kompania “Karakushi” SH.P.K. është paraqitur përmes skicës dhe planimetrisë përkatëse, të cilat ilustrojnë shtrirjen hapësinore të projektit në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Në hartën orientuese në nivel të Republikës së Kosovës paraqitet pozicioni i lokacionit në territorin jugperëndimor të vendit, përkatësisht në Komunën e Gjakovës. Kjo paraqitje mundëson identifikimin e qartë të vendndodhjes së projektit në kontekstin më të gjerë gjeografik. Në paraqitjen rajonale është theksuar zona kadastrale Zhub, ku ndodhet parcela me numër P-70705033-00426-0. Kjo hartë tregon shtrirjen e projektit brenda territorit administrativ të Komunës së Gjakovës dhe raportin e tij me vendbanimet përreth dhe elementet natyrore të zonës. Në planimetrinë në nivel lokal paraqitet kufiri i parcelës ku do të realizohet zgjerimi i zonës së eksploatimit, i evidentuar me vijëzim dhe sipërfaqe të theksuar. Gjithashtu, janë paraqitur koordinatat e pikave kufitare të parcelës, pozicioni i zonës së zgjerimit brenda hapësirës minerare.




Figura 2. Shtrirja hapësinore e Lokacionit të projektit në territorin e Komunës së Gjakovës

Në skicat përkatëse është paraqitur gjithashtu lidhja rrugore e lokacionit të projektit me qytetin e Gjakovës dhe vendbanimet përreth, përmes rrjetit ekzistues rrugor.




Figura 3. Distanca e kompanisë me qytetin e Gjakovës

3.3.Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti

Zona e projektit për zgjerimin e eksplotimit të bazalteve në lokalitetin Zhub në komunën e Gjakovës ndodhet në distancë mbi 1 kilometër nga qendrat më të afërta të banuara. Lokacioni është i pozicionuar në zonë minerare dhe pyjore, jashtë perimetrit të drejtpërdrejtë të vendbanimeve. Kjo distancë konsiderohet e mjaftueshme për të kufizuar ndikimet e mundshme si zhurma, pluhuri dhe vibrimet në zonat e banuara.



Figura 4. Distanca e Kompanisë nga Shtëpi Banimi

3.4.Paraqitje e karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit

Territori i Komunës së Gjakovës karakterizohet nga përbërje të ndryshme pedologjike dhe morfologjike. Në zonat fushore dominojnë tokat aluviale dhe deluviale, të cilat janë mjaft pjellore dhe të përshtatshme për kultivim. Sipas të dhënave të EULUP dhe Planit lokal të veprimit në mjedis, pjesë e konsiderueshme e territorit përbëhet nga aluviumi, sedimente liqenore dhe materiale të përziera si rërë, argjilë dhe zhavorr. Zona e projektit në lokalitetin Kodrina e Gjakovës ndodhet në terren me karakter mineral dhe me mbulesë të kufizuar toke bujqësore, pasi dominon substrati shkëmbor bazaltik. Shtresa e humusit është e cekët dhe në pjesët e eksplotimit paraqitet kryesisht terren shkëmbor. Relievi i Komunës së Gjakovës përfshin zona fushore dhe kodrinore-malore. Lokacioni i projektit ndodhet në zonë kodrinore, me pjerrësi të theksuar dhe konfiguracion tipik për formacione vullkanike dhe sedimentare të

konsoliduara. Terreni paraqet stabilitet natyror të mirë për aktivitete minerare sipërfaqësore, por kërkon respektim të parametrave teknikë për stabilitetin e skarpave gjatë fazës së minimimit. Nga aspekti gjeologjik, territori i Gjakovës përbëhet nga formacione të ndryshme shkëmbore, përfshirë serpentinite, gabbro, diabase, basalt dhe formacione sedimentare si gëlqerorë dhe konglomerate. Zona e projektit karakterizohet nga prania e formacioneve bazaltike dhe shkëmbinjve magmatikë, të cilët përbëjnë burimin mineral të eksploatimit. Këto formacione kanë qëndrueshmëri të lartë mekanike dhe janë të përshtatshme për përdorim në ndërtim dhe infrastrukturë. Komuna e Gjakovës bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të Drinit të Bardhë. Lumenjtë kryesorë janë Ereniku, Krena dhe Trakaniqi, ndërsa në territor ndodhet edhe Liqeni i Radoniqit, me kapacitet maksimal rreth 117 milion m³. Territori i Kosovës konsiderohet zonë me aktivitet sizmik të moderuar. Komuna e Gjakovës bën pjesë në zonën sizmogjene Prizren–Pejë, ku magnituda maksimale e mundshme arrin deri në rreth $M = 6.6$ sipas shkallës Rihter.

3.5. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë

Në kuadër të projektit për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga “Karakushi” SH.P.K., nuk parashihet përdorim i ujit për proces pune. Aktiviteti përfshin vetëm minimin, mbushjen e materialit në kamion dhe transportin e tij drejt vendit të thërrmimit, pa zhvillim të proceseve teknologjike që kërkojnë furnizim me ujë. Kompania do të sigurojë furnizimin me ujë për punëtorët përmes cisternave të ujit.

3.6. Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik

Komuna e Gjakovës karakterizohet nga klimë kontinentale me verë të nxehtë dhe dimër të ftohtë. Muaji më i nxehtë i vitit është korriku, ndërsa muaji më i ftohtë është janari.

Pozita gjeografike e Gjakovës në rrethinën e pellgut të Drinit të Bardhë ndikon që në këtë rajon të dominojë klima mesatare kontinentale me ndikim të klimës mesdhetare, e cila depërton përgjatë luginës së Drinit të Bardhë.

Bazuar në të dhënat shumëvjeçare klimatike, zona karakterizohet nga këta tregues meteorologjikë:

- Temperatura mesatare vjetore është rreth +11.9 °C.
- Muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare rreth -0.1 °C.
- Muaji më i nxehtë është gushti me temperaturë mesatare rreth +22.2 °C.
- Temperatura mesatare gjatë sezonit vegjetativ është rreth 18.6 °C.
- Sasia mesatare e reshjeve vjetore është rreth 754.8 mm.
- Sasia e reshjeve gjatë sezonit vegjetativ është rreth 342.9 mm.

3.7. Prezantimi i karakteristikat natyrore

Komuna e Gjakovës karakterizohet nga një kombinim i elementeve natyrore fushore dhe kodrinore-malore. Territori përfshin zona të pellgut të Drinit të Bardhë, me rrjedha kryesore si lumi Erenik, Krena dhe Trakaniqi, si dhe Liqenin e Radoniqit që përbën një nga rezervuarët më të rëndësishëm ujorë në rajon. Relievi paraqet alternim ndërmjet zonave të ulëta aluviale dhe zonave kodrinore me substrat shkëmbor. Në pjesën ku ndodhet projekti (Kodrina e Gjakovës, Zhub), terreni ka karakter kodrinor me dominim të formacioneve shkëmbore bazaltike, me mbulesë të kufizuar vegjetative. Nga aspekti biogeografik, territori përfshin sipërfaqe bujqësore, zona pyjore dhe hapësira natyrore me biodiversitet tipik për rajonin perëndimor të Kosovës. Pyjet përfaqësojnë një resurs të rëndësishëm natyror, ndërsa zonat e hapura kodrinore karakterizohen nga vegjetacion barishtor dhe shkurre. Zona e projektit nuk ndodhet brenda ndonjë zone të mbrojtur natyrore sipas kategorizimeve komunale dhe kombëtare, dhe nuk identifikohet si habitat i veçantë me ndjeshmëri të lartë ekologjike.

3.8. Rishikimi i karakteristikat themelore të peizazhit

Peizazhi i Komunës së Gjakovës është i përbërë nga një mozaik elementesh natyrore dhe antropogjene. Në zonat fushore dominojnë sipërfaqet bujqësore dhe vendbanimet, ndërsa në zonat kodrinore dhe malore dominojnë formacionet shkëmbore dhe sipërfaqet pyjore. Lokacioni i projektit në Kodrinën e Gjakovës karakterizohet nga një peizazh natyror kodrinor me dominim të masiveve shkëmbore dhe mbulesë të pjesshme vegjetative. Pamja vizuale e zonës është tipike për zona minerare, ku ndërhyrjet ekzistuese të eksploatimit janë tashmë pjesë e karakterit peizazhor lokal. Nga pikëpamja vizuale, zona nuk ndodhet në afërsi të qendrave urbane apo korridoreve kryesore turistike, dhe ndikimi peizazhor i zgjerimit të eksploatimit do të mbetet i kufizuar brenda perimetrit të parcelës minerare. Pas përfundimit të aktivitetit, rehabilitimi i sipërfaqes do të kontribuojë në integrimin gradual të zonës në peizazhin përreth, duke zvogëluar kontrastin vizual të ndërhyrjes minerare.

3.9. Rishikimi i objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike

Në zonën ku do të bëhet zgjerimi i zonës së eksploatimit të bazalteve, nuk janë identifikuar objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike brenda parcelave të projektit apo në afërsi të drejtpërdrejtë të tyre.

3.10. Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar

Komuna e Gjakovës, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka pasur 94,556 banorë, që përfaqëson rreth 5.5% të popullsisë së përgjithshme të

Kosovës. Në nivel kombëtar, Kosova sipas regjistrimit të vitit 2011 kishte 1,795,666 banorë. Dinamika demografike në dekadat e fundit ka shfaqur ndryshime, ku pas një periudhe rritjeje natyrore, trendi ka shënuar stabilizim dhe në disa zona edhe rënie të lehtë për shkak të emigrimit. Struktura demografike e Komunës së Gjakovës karakterizohet nga përqendrim më i madh i popullsisë në zonat urbane dhe fushore, ndërsa zonat kodrinore dhe rurale kanë dendësi më të ulët banimi.

3.11. Të dhëna për objektet ekzistuese

Projekti në afësi nuk ka object afër shtëpitë e banimit I ka distanc më shumë se 1km ndërsa në një distancë prej rreth 133.07 metra nga separacioni i kompanisë.

3.12. Në varësi të karakteristikave të zonës, përshkrimi i lokacionit përmban edhe të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkeologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme

Bazuar në dokumentacionin planifikues në fuqi, gjendjen ekzistuese në terren dhe të dhënat në dispozicion për zonën e Zhub, Komuna e Gjakovës, në hapësirën ku do të bëhte zgjerimi i zonës së eksploatimit të bazalteve, nuk janë identifikuar zona me vlera të veçanta shkencore, vende arkeologjike të regjistruara, apo zona veçanërisht të ndjeshme mjedisore brenda parcelës së projektit apo në afërsi të drejtpërdrejtë të saj.

3.13. Të dhënat për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dh në afësi të saj

Në afërsi të projektit nuk ka burime ujore.

4. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR

4.1. Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor

Duke u fokusuar në komponentët kryesorë mjedisorë që karakterizojnë territorin e Komunës së Gjakovës dhe zonën ku planifikohet zgjerimi i eksploatimit të bazalteve. Në territorin e Komunës së Gjakovës, cilësia e ajrit ndikohet kryesisht nga trafiku rrugor, ngrohja individuale gjatë sezonit dimëror dhe aktivitetet ekonomike në zonat urbane. Ndotja është më e theksuar në qytet dhe përgjatë akseve kryesore rrugore, ndërsa në zonat rurale dhe kodrinore niveli i ndotjes është më i ulët. Komuna bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të Drinit të Bardhë. Lumenjtë kryesorë janë Ereniku, Krena dhe Trakaniqi. Gjendja e ujërave sipërfaqësore ndikohet nga shkarkimet urbane dhe aktivitetet bujqësore. Në territor ndodhet edhe Liqeni i Radoniqit, i cili ka rëndësi të veçantë për furnizim me ujë dhe zhvillim ekonomik. Në disa zona të komunës është evidentuar ndjeshmëri e mesme deri e lartë e ujërave nëntokësore, veçanërisht në zonat aluviale dhe fushore. Këto zona kërkojnë kujdes në planifikimin e aktiviteteve që mund të ndikojnë në infiltrimin e ndotësve. Komuna karakterizohet nga përbërje të ndryshme pedologjike, ku në zonat fushore dominojnë tokat aluviale dhe deluviale me pjellori të lartë. Në zonat kodrinore dhe malore dominon substrati shkëmbor dhe toka me pjellori më të kufizuar. Në disa zona janë evidentuar degradime të tokës si pasojë e shfrytëzimit jo të kontrolluar të burimeve natyrore. Territori i komunës përfshin zona pyjore dhe habitate natyrore me vlera ekologjike. Pyjet përbëjnë një resurs të rëndësishëm natyror dhe ekonomik. Biodiversiteti është i lidhur ngushtë me relievin dhe tiparet klimatike të rajonit. Ndotja akustike është më e theksuar në zonat urbane dhe përgjatë rrugëve kryesore. Në zonat rurale niveli i zhurmës është i ulët dhe i lidhur kryesisht me aktivitetet bujqësore ose industriale lokale.

5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT

5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme

Në kuadër të projektit për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga “Karakushi” SH.P.K., janë shqyrtuar këto alternativa të realizueshme:

A. Zgjerimi i zonës së eksploatimit në lokacionin ekzistues (alternativa e propozuar)

florës, faunës dhe pasurive natyrore të mbrojtura, në dokument nuk janë identifikuar vlera të veçanta shkencore, zona të mbrojtura natyrore, habitate të ndjeshme apo specie të rralla dhe të rrezikuara brenda zonës së projektit apo në afërsi të drejtpërdrejtë të saj. Për këtë arsye, ndikimi në këta komponentë vlerësohet si i ulët, lokal dhe i kufizuar kryesisht në sipërfaqen e drejtpërdrejtë të ndërhyrjes.

6.27. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve

Sipërfaqja e përfshirë në projekt ka qëllim të qartë minerar dhe do të shfrytëzohet për zgjerimin e zonës së eksplotimit të bazalteve. Përdorimi i kësaj hapësire është në funksion të minimimit të masës shkëmbore, organizimit të fronteve të punës, lëvizjes së makinerive dhe transportit të materialit drejt separacionit. Duke qenë se zona paraqet karakter minerar dhe pyjor, me dominim të substratit shkëmbor dhe me tokë bujqësore të kufizuar, shfrytëzimi i saj për aktivitet eksplotues konsiderohet në përputhje me funksionin aktual dhe me natyrën e lokacionit.

6.28. Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara

Projekti nuk përfshin ndërtim objektsh industriale apo rezidenciale në kuadër të zgjerimit të zonës së eksplotimit. Aktiviteti zhvillohet në një sipërfaqe të hapur, pa struktura të përhershme ndërtimore, dhe përfshin vetëm organizimin funksional të hapësirës për minimin, rrugët e brendshme, manovrimin e makinerive dhe transportin e materialit. Për këtë arsye, ndikimi i projektit lidhet kryesisht me transformimin e sipërfaqeve të pa ndërtuara natyrore ose gjysmë natyrore në sipërfaqe operative minerare, pa rritje të konsiderueshme të sipërfaqeve të ndërtuara.

6.29. Shfrytëzimi i tokës

Shfrytëzimi i tokës në kuadër të projektit do të orientohet plotësisht drejt aktivitetit minerar, përkatësisht eksplotimit të bazalteve. Kjo nënkupton heqjen e shtresës sipërfaqësore në zonën e ndërhyrjes, formimin e fronteve të minimimit dhe përdorimin e sipërfaqes për qarkullim të makinerive dhe kamionëve. Duke qenë se zona nuk paraqitet si tokë bujqësore me vlerë të lartë dhe karakterizohet nga terren shkëmbor bazaltik, ndikimi në shfrytëzimin e tokës vlerësohet si i kufizuar në aspektin e konkurrencës me përdorime të tjera të mundshme. Pas përfundimit të aktivitetit, sipërfaqja do t'i nënshtrohet rehabilitimit, me qëllim stabilizimin e terrenit dhe rikthimin gradual të funksionit mjedisor të saj.

6.30. Infrastruktura komunale

Ndikimi i projektit në infrastrukturën komunale vlerësohet i kufizuar, pasi aktiviteti i zgjerimit të zonës së eksplotimit të bazalteve zhvillohet në një zonë ekzistuese minerare dhe nuk kërkon

ndërtim të infrastrukturës së re komunale jashtë perimetrit të parcelës. Projekti mbështetet kryesisht në qasjen ekzistuese rrugore dhe në organizimin e brendshëm të hapësirës për qarkullimin e makinerive dhe kamionëve. Për rrjedhojë, ndikimi mbi infrastrukturën komunale mbetet i ulët dhe i menaxhueshëm.

6.31. Trafiku

Projekti nuk pritet të ketë ndikim në trafik, pasi kamionët që transportojnë gurin bazaltik lëvizin brenda zonës së kompanisë, duke përfshirë zonën e thërmimit dhe separacionet, të cilat ndodhen pranë dhe të lidhura direkt me zonën e eksploatimit, pa u futur në rrugët publike. Brenda zonës së projektit do të organizohen rrugë të brendshme për qarkullim të kontrolluar të makinerive dhe kamionëve, me qëllim shmangien e pengesave operative dhe rritjen e sigurisë gjatë punës.

6.32. Furnizimi me ujë

Në kuadër të projektit nuk parashihet furnizim me ujë për proces pune, pasi aktiviteti përfshin vetëm minimin, ngarkimin dhe transportin e materialit, pa zhvillim të proceseve teknologjike që kërkojnë përdorim të ujit.

6.33. Energjia

Projekti nuk kërkon furnizim me energji elektrike për procese prodhuese apo përpunim industrial, pasi në lokacion nuk realizohet thërmim apo trajtim i materialit.

6.34. Ujërat e zeza

Projekti nuk gjeneron ujëra të zeza teknologjike apo industriale, pasi aktiviteti nuk përfshin procese përpunimi dhe nuk përdor ujë në proces pune.

6.35. Gjenerimi i mbeturinave

Gjatë operimit të projektit nuk gjenerohen mbeturina industriale apo mbetje nga përpunimi, pasi në lokacion zhvillohet vetëm minimi dhe transporti i materialit bazaltik. Mbeturinat kryesore që krijohen janë mbeturinat komunale të gjeneruara nga personeli gjatë qëndrimit në vendpunishte, si ambalazhe ushqimore, shishe plastike dhe mbetje të tjera të zakonshme. Sasia e tyre është e vogël dhe lidhet drejtpërdrejt me numrin e punëtorëve dhe kohëzgjatjen e operimit. Këto mbeturina do të grumbullohen në mënyrë të kontrolluar dhe do të largohen përmes sistemit komunal ose operatorit të kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave.

6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit

Bazuar në të dhënat e përfshira në raport, në zonën e projektit dhe në afërsinë e drejtpërdrejtë të saj nuk janë identifikuar pasuri të mbrojtura natyrore, objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike apo zona me vlera të veçanta shkencore dhe arkeologjike. Për këtë arsye, projekti nuk pritet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në këto kategori vlerash të mbrojtura. Sa i përket peizazhit, ndikimi lidhet me ndryshimin progresiv të relievit dhe me zgjerimin e sipërfaqes së eksploatimit brenda një zone tashmë me karakter minerar, ndaj efekti vizual vlerësohet lokal dhe i kufizuar.

6.37. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përmban gjithashtu informacione që rezultojnë nga

Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis për projektin e zgjerimit të zonës së eksploatimit të bazaltëve, bazohet në natyrën e aktivitetit të planifikuar, në karakteristikat e lokacionit, në mënyrën e zhvillimit të procesit të minimit dhe transportit, si dhe në gjendjen ekzistuese të faktorëve mjedisorë në zonën e projektit. Vlerësimi është mbështetur në të dhënat për relievin, përbërjen gjeologjike, përdorimin aktual të sipërfaqes, distancën nga vendbanimet, mungesën e proceseve industriale në lokacion, si dhe në identifikimin e ndikimeve tipike që lidhen me aktivitete minerare sipërfaqësore, si pluhuri, zhurma, vibrimet dhe ndryshimi i topografisë. Në këtë kuadër janë marrë parasysh edhe masat e planifikuara për kontrollin e ndikimeve dhe rehabilitimin progresiv të sipërfaqes së shfrytëzuar.

6.38. Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit

Zbatimi i projektit përfshin fillimisht punët përgatitore në terren, të cilat konsistojnë në pastrimin e sipërfaqes nga vegjetacioni dhe materialet e papërshtatshme, largimin dhe ruajtjen e shtresës humusore, sistemimin e terrenit dhe hapjen e rrugëve të brendshme për qarkullimin e makinerive dhe kamionëve. Pas kësaj faze zhvillohet aktiviteti kryesor i minimit, i cili përfshin shpimin, shpërthimet e kontrolluara, ngarkimin e materialit dhe transportin e tij. Në përfundim të operimeve ose në rast të largimit nga zona e eksploatimit, lokacioni duhet të rehabilitohet dhe të rikthehet në gjendjen e tij të mëparshme sa më afër të mundshme.

6.39. Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese

Ndikimet kumulative të projektit vlerësohen të kufizuara, pasi në afërsi të lokacionit nuk janë evidentuar aktivitete të tjera industriale që mund të krijojnë ndikime të ndërsjella të theksuara me projektin. Ndërlidhja kryesore funksionale ekziston me separacionin e kompanisë, i cili

ndodhet në afërsi dhe pranon materialin e nxjerrë për përpunim të mëtejshëm. Duke qenë se vetë zona e zgjerimit nuk përfshin proces të përpunimit industrial, ndikimet kumulative mbeten kryesisht të lidhura me transportin, pluhurin dhe zhurmën nga aktiviteti mineral dhe lëvizja e mjeteve. Në përgjithësi, këto ndikime vlerësohen të menaxhueshme dhe të kufizuara në hapësirën funksionale të aktivitetit ekzistues të kompanisë.

6.40. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis

Shtrirja hapësinore e ndikimeve negative të projektit pritet të jetë kryesisht lokale dhe e kufizuar brenda zonës së eksploatimit dhe në afërsinë e saj të menjëhershme. Ndikimet më të theksuara, si pluhuri, zhurma, vibrimet dhe ndryshimi i relievit, do të paraqiten në frontet e punës, përgjatë rrugëve të brendshme dhe në zonat e manovrimit të makinerive. Me rritjen e distancës nga burimi i ndikimit, intensiteti i këtyre efekteve pritet të ulet ndjeshëm. Duke qenë se lokacioni ndodhet mbi 1 km larg qendrave të banuara, ndikimet negative në popullsinë përreth vlerësohen të kufizuara dhe pa shtrirje të gjerë territoriale.

6.41. Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit

Projekti nuk përfshin fazë ndërtimi dhe nuk pritet përdorimi i ujit.

6.42. Emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit

Në kuadër të projektit nuk parashihen procese, pajisje apo instalime që gjenerojnë rrezatim elektromagnetik me ndikim të rëndësishëm mjedisor ose shëndetësor gjatë fazës së zbatimit.

6.43. Emetimet në ajër të gazeve serrë gjatë operimit

Gjatë operimit, emetimet e gazeve serrë lidhen kryesisht me përdorimin e karburantit dizel nga makineritë minerare, pajisjet për shpim, ekskavatorët dhe kamionët transportues. Burimi kryesor i këtyre emetimeve është djegia e naftës, e cila gjeneron kryesisht dioksid karboni CO₂, si dhe sasi më të vogla të gazeve të tjera të lidhura me procesin e djegies. Duke qenë se në lokacion nuk zhvillohet proces industrial, nuk ka djegie stacionare dhe nuk përdoret energji elektrike për prodhim, niveli i emetimeve të gazeve serrë vlerësohet relativisht i kufizuar dhe i lidhur drejtpërdrejt me intensitetin e operimit dhe transportit.

6.44. Ndikimet në ndryshimet klimatike

Ndikimi i projektit në ndryshimet klimatike vlerësohet i ulët, pasi aktiviteti ka karakter lokal dhe nuk përfshin procese industriale me emetime të larta. Kontributi i projektit në ndryshimet klimatike lidhet kryesisht me emetimet e CO₂ nga përdorimi i karburantit për makineritë dhe transportin..

7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS

7.1.Masat e parashikuara me legjislacion

Për realizimin e projektit për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga kompania “Karakushi” SH.P.K., duhet të zbatohen të gjitha masat e parashikuara me legjislacionin mjedisor dhe sektorial në fuqi në Republikën e Kosovës. Këto masa përfshijnë respektimin e kushteve të përcaktuara në procedurën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, zbatimin e kërkesave të lejes mjedisore dhe të lejes minerare, menaxhimin e mbeturinave në përputhje me legjislacionin për mbeturina, kontrollin e emetimeve në ajër, mbrojtjen e tokës nga degradimi dhe ndotja, si dhe zbatimin e masave për siguri dhe mbrojtje në punë. Po ashtu, kompania duhet të sigurojë kontroll të vazhdueshëm teknik të makinerive, ruajtje dhe trajtim të sigurt të karburanteve dhe materialeve ndihmëse, si dhe rehabilitim të sipërfaqeve të shfrytëzuara në përputhje me planin e mbylljes dhe kërkesat e autoriteteve kompetente.

7.2.Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha

Në rast të aksidenteve dhe fatkeqësive të mëdha, do të ndërmerren masa urgjente për të siguruar sigurinë e punëtorëve dhe për të zvogëluar pasojat e mundshme. Këto masa përfshijnë:

- Aktivizimin e menjëhershëm të ekipit të reagimit për emergjencat, i cili do të sigurojë ndihmën e parë dhe do të organizojë largimin e sigurt të personelit nga zona e rrezikut.
- Aktivizimin e sistemeve të paralajmërimit dhe evakuimit të punëtorëve, duke u siguruar që ata të mbërrijnë në pikat e sigurisë sa më shpejt.
- Përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të emergjencës për të ndaluar përhapjen e dëmeve, siç janë sistemet e shpëtimit, zjarrit dhe ndihmës së shpejtë.
- Informimin dhe bashkëpunimin me autoritetet lokale dhe ekipet e shpëtimit për të koordinuar masat dhe pasojat në shkallë më të gjerë.
- Përdorimin e planeve të parapërgatitura për situata emergjente që sigurojnë që të gjitha masat të merren në përputhje me rregulloret ligjore dhe praktikat më të mira të sigurisë.

Ky plan ka për qëllim minimizimin e dëmeve dhe rikuperimin sa më të shpejtë të zonës dhe operacionit.

7.3.Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit

Për mbrojtjen e mjedisit gjatë operimit të projektit duhet të zbatohen zgjidhje teknike dhe organizative që synojnë kufizimin e ndikimeve në ajër, tokë, peizazh dhe shëndetin e njeriut. Këto përfshijnë organizimin e kontrolluar të fronteve të minimit, ruajtjen dhe përdorimin e shtresës humusore për rehabilitim, mirëmbajtjen e rregullt të rrugëve të brendshme dhe të

makinerive, si dhe respektimin e parametrave teknikë gjatë shpërthimeve të kontrolluara. Rrugët e qarkullimit dhe zonat operative duhet të sistemohen në mënyrë që të kufizohet ngritja e pluhurit dhe të rritet siguria e lëvizjes së mjeteve. Makineritë duhet të jenë në gjendje të mirë teknike për të reduktuar emetimet, zhurmën dhe rrezikun e rrjedhjeve aksidentale. Gjithashtu, duhet të parashihet rehabilitimi progresiv i sipërfaqeve të shfrytëzuara, me qëllim stabilizimin e terrenit dhe rikthimin gradual të funksionit mjedisor të zonës.

7.4. Masat të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e efekteve të dëmshme në mjedis

Përveç masave të parashikuara me legjislacion dhe zgjidhjeve teknike, kompania duhet të zbatojë edhe masa shtesë organizative dhe parandaluese për të zvogëluar ndikimet e mundshme në mjedis. Këto masa përfshijnë kufizimin e operimeve në orare të përshtatshme, në mënyrë që të minimizohet shqetësimi nga zhurma dhe vibrimet, kontrollin periodik të gjendjes së terrenit dhe të skarpave, monitorimin e ndikimeve gjatë operimit, si dhe evidentimin dhe adresimin e menjëhershëm të çdo parregullsie mjedisore. Mbeturinat komunale të krijuara nga personeli duhet të grumbullohen ndaras dhe të largohen në mënyrë të rregullt nga operatori përkatës. Personeli duhet të jetë i trajnuar për zbatimin e masave të mbrojtjes së mjedisit dhe të sigurisë në punë. Këto masa do të kontribuojnë në parandalimin, reduktimin dhe menaxhimin efektiv të ndikimeve negative gjatë gjithë ciklit të operimit të projektit.

8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis

Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis ka për qëllim sigurimin e kontrollit të vazhdueshëm të aktiviteteve të zgjerimit të zonës së eksploatimit të bazalteve nga kompania “Karakushi” SH.P.K., me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe kushtet e lejes mjedisore dhe minerare. Monitorimi synon identifikimin në kohë të çdo ndikimi të mundshëm negativ në mjedis dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese në rast të devijimeve. Gjatë operimit do të monitorohen kryesisht: niveli i pluhurit në zonën e punës, nivelet e zhurmës dhe vibrimeve nga shpërthimet dhe makineritë, gjendja e terrenit dhe stabiliteti i skarpave, si dhe menaxhimi i mbeturinave komunale dhe kontrolli i mundshëm i rrjedhjeve të karburantit apo vajrave. Monitorimi do të realizohet përmes kontrollit të brendshëm nga kompania, në përputhje me planin minerar dhe kërkesat e autoriteteve kompetente, duke siguruar që aktiviteti të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar dhe të qëndrueshme nga ana mjedisore.

8.2. Prezantimin e gjendjes mjedisore përpara se projekti të vihet në punë ose fillimi i aktiviteteve në vendet ku ndikimi mjedisor pritet

Gjendja mjedisore para fillimit të zgjerimit të zonës së eksploatimit në lokalitetin e fshati Zhub, karakterizohet nga një zonë me aktivitet ekzistues minerar. Terreni është pjesërisht i modifikuar nga eksploatimi paraprak, prandaj nuk konsiderohet zonë e paprekur natyrore. Në aspektin e ajrit, cilësia ndikohet kryesisht nga pluhuri lokal gjatë operimeve ekzistuese dhe nga qarkullimi i kamionëve, sidomos në periudha të thata. Në aspektin e tokës, zona përfshin sipërfaqe shkëmbore dhe terren të përdorur për aktivitet minerar, me ndryshime të relievit brenda perimetrit të eksploatimit. Sa i përket ujërave, në lokacion nuk ka përdorim uji dhe nuk ka shkarkime industriale. Gjendja ekzistuese shërben si bazë për krahasimin e ndikimeve që mund të paraqiten nga zgjerimi i aktivitetit, duke qenë se zona tashmë ka karakter minerar.

8.3. Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis

Për aktivitetin e zgjerimit të zonës së eksploatimit të bazalteve nga “Karakushi” SH.P.K., parametrat kryesorë që do të monitorohen për të përcaktuar efektet e mundshme të dëmshme në mjedis lidhen me cilësinë e ajrit, nivelet e zhurmës dhe vibrimeve, gjendjen e tokës dhe menaxhimin e mbeturinave. Do të vlerësohet niveli i pluhurit gjatë minimit, ngarkimit dhe transportit të materialit, si dhe emetimet nga makineritë dhe kamionët me motor dizel. Po ashtu do të monitorohen nivelet e zhurmës dhe vibrimeve gjatë shpërthimeve të kontrolluara dhe funksionimit të pajisjeve minerare. Gjendja e tokës do të kontrollohet për stabilitetin e terrenit

dhe për çdo rrjedhje të mundshme të karburantit apo vajrave, ndërsa do të mbikëqyret edhe menaxhimi i mbeturinave komunale nga personeli dhe organizimi i rrjedhjeve sipërfaqësore nga reshjet. Monitorimi i vazhdueshëm i këtyre parametrave mundëson identifikimin në kohë të çdo devijimi nga kushtet e lejuara dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese, në mënyrë që ndikimet mjedisore të mbeten të kontrolluara dhe brenda standardeve ligjore.

8.4.Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar

Matjet dhe kontrollimet do të realizohen brenda zonës së zgjerimit të eksploatimit, kryesisht në frontet e punës, në rrugët e brendshme të qarkullimit dhe në pikat ku realizohen shpërthimet dhe ngarkimi i materialit. Sipas nevojës, kontrollime mund të kryhen edhe në kufijtë e parcelës minerare për të vlerësuar përhapjen e pluhurit dhe zhurmës. Gjatë periudhave me aktivitet më intensiv, si në fazat me shpërthime më të shpeshta, monitorimi do të jetë më i rregullt. Në operim normal, kontrollet do të kryhen në mënyrë periodike, përmes inspektimeve të brendshme dhe vlerësimeve teknike. Matjet e zhurmës, pluhurit apo vibrimeve, kur kërkohet nga autoritetet kompetente ose sipas kushteve të lejes mjedisore, do të realizohen me pajisje të përshtatshme dhe nga persona apo institucione të autorizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8.5.Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera

Raportet e monitorimit për projektin e zgjerimit të zonës së eksploatimit të bazalteve do të përfshijnë rezultatet e matjeve dhe kontrolleve të kryera për pluhur, nivelet e zhurmës dhe vibrimeve, gjendjen e terrenit, si dhe menaxhimin e mbeturinave komunale dhe kontrollin e mundshëm të rrjedhjeve të karburantit apo vajrave. Në raport do të përfshihet analiza e të dhënave dhe krahasimi me vlerat kufitare të lejuara sipas legjislacionit në fuqi. Në rast se evidentohen devijime nga standardet e lejuara, raporti do të përmbajë edhe masa korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes. Dorëzimi i raporteve do të bëhet në mënyrë periodike, sipas kërkesave të autoriteteve kompetente dhe kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore dhe minerare, duke siguruar transparencë dhe përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.

8.6.Detyrimi për të informuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera

Kompania “Karakushi” SH.P.K. është e obliguar të sigurojë transparencë dhe të informojë publikun lidhur me rezultatet e monitorimit mjedisor për aktivitetin e zgjerimit të zonës së eksploatimit të bazalteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e lejes mjedisore dhe minerare. Informimi realizohet përmes raporteve zyrtare që i dorëzohen autoriteteve kompetente, ndërsa në rast se kërkohet, rezultatet mund të bëhen publike përmes njoftimeve

apo formave të tjera të komunikimit të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse. Kjo siguron që aktiviteti të zhvillohet me përgjegjësi dhe në përputhje me parimet e transparencës dhe mbrojtjes së mjedisit.

8.7. Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis

Zona e zgjerimit të eksploatimit të bazalteve në fshatin Zhub, Komuna e Gjakovës, ndodhet rreth 3 km vije ajrore nga kufiri me Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, bazuar në natyrën e aktivitetit, i cili përfshin vetëm minimin dhe transportin e materialit brenda territorit të Republikës së Kosovës, nuk parashikohen ndikime të drejtpërdrejta dhe të matshme që mund të shtrihen përtej kufirit shtetëror. Ndikimet e projektit janë lokale dhe lidhen kryesisht me pluhurin, zhurmën dhe ndryshimin e relievit brenda zonës së eksploatimit. Duke qenë se nuk ka shkarkime në ujëra ndërkufitare, nuk ka emetime industriale me përhapje të gjerë dhe nuk ka përdorim të burimeve që mund të ndikojnë jashtë territorit, rreziku për ndikim ndërkufitar vlerësohet shumë i ulët. Për rrjedhojë, projekti nuk kërkon program të veçantë ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis.

9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

9.1.Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit

Plani i Menaxhimit Mjedor synon të sigurojë mbrojtje efektive të mjedisit gjatë të gjitha fazave të zgjerimit të zonës së eksploatimit të bazalteve, përfshirë fazën përgatitore, fazën e operimit dhe fazën e mbylljes së aktivitetit. Gjatë fazës përgatitore do të zbatohet organizim i kontrolluar i punimeve në terren, me kufizim të ndërhyrjeve vetëm brenda perimetrit të parcelës minerare dhe me kujdes ndaj pluhurit, zhurmës dhe stabilitetit të terrenit. Gjatë fazës së operimit, fokusi do të jetë në realizimin e minimit në përputhje me planin teknik, mirëmbajtjen e rregullt të makinerive, kontrollin e pluhurit dhe zhurmës, menaxhimin e mbeturinave komunale dhe parandalimin e çdo rrjedhjeje aksidentale të karburantit apo vajrave. Aktiviteti do të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar kushtet e lejes mjedisore dhe minerare. Në rast të përfundimit të eksploatimit, do të zbatohet mbyllje e kontrolluar e zonës, stabilizim i terrenit dhe rehabilitim i sipërfaqes së shfrytëzuar, me qëllim lënien e lokacionit në gjendje të sigurt dhe të qëndrueshme nga aspekti mjedor.

9.2.Pajtushmeria me pëlqim mjedor

Zbatimi dhe operimi i projektit për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve do të realizohet në përputhje të plotë me kushtet e përcaktuara në pëlqimin mjedor dhe legjislacionin mjedor në fuqi. Kompania është përgjegjëse për zbatimin e të gjitha masave mbrojtëse mjedisore të përcaktuara në raport, për monitorimin e rregullt të ndikimeve në ajër, zhurmë, tokë dhe për menaxhimin e mbeturinave, si dhe për raportimin periodik pranë autoriteteve kompetente. Po ashtu, kompania do të bashkëpunojë me organet mbikëqyrëse dhe inspektuese dhe do të sigurojë qasje në informacion dhe dokumentacion sipas kërkesave ligjore. Çdo ndryshim eventual në kapacitetin e nxjerrjes, mënyrën e operimit apo parametrat teknikë do të trajtohet në përputhje me procedurat ligjore dhe do të njoftohen autoritetet kompetente para zbatimit të tyre.

9.3.Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedor në përputhje me standardin ISO 14000

Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të performancës mjedisore, kompania synon zhvillimin dhe forcimin e sistemit të menaxhimit mjedor, në përputhje me parimet e standardit ISO 14000. Zbatimi i këtij sistemi do të kontribuojë në: identifikimin dhe kontrollin sistematik të ndikimeve mjedisore, përmirësimin e efikasitetit operativ, rritjen e përgjegjësisë mjedisore të personelit, përmbushjen më të lartë të kërkesave ligjore dhe institucionale.

10. INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT

10.1. Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së,

Projekti për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga kompania “Karakushi” SH.P.K. është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe aktet nënligjore përkatëse, me qëllim sigurimin e një vlerësimi të plotë dhe realist të ndikimeve mjedisore. Karakteristikat kryesore që kanë ndikuar në përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së këtij raporti janë natyra e aktivitetit minerar sipërfaqësor, procesi që përfshin vetëm minimin, ngarkimin dhe transportin e bazaltit, mungesa e përpunimit industrial në lokacion, si dhe fakti që zona tashmë ka karakter minerar. Projekti nuk përfshin përdorim uji në proces, nuk ka djegie industriale dhe nuk gjeneron ujëra teknologjike. Ndikimet kryesore mjedisore janë të natyrës lokale dhe lidhen me pluhurin, zhurmën, vibrimet, ndryshimin e relievit dhe lëvizjen e mjeteve transportuese. Informacionet e përfshira në këtë raport synojnë të sigurojnë qartësi, përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe bazë të mjaftueshme për përcaktimin e masave mbrojtëse, me qëllim që aktiviteti të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar dhe të qëndrueshme nga aspekti mjedisor.

10.2. Baza ligjore dhe rregullative

Hartimi i këtij Raporti të VNM-së është mbështetur në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës, e cila është e harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian për industrinë nxjerrëse dhe mbrojtjen e mjedisit.

Ligjet dhe Udhëzimet Administrative

- Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis: Ligji bazë që rregullon
- Procedurat e Raportit të Vlerësimit të ndikimit në Mjedis
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit: Përcakton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minalet (i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158): Rregullon shfrytëzimin e resurseve minerale.
- Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja: Për limitet e pluhurit dhe gazeve.
- Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina: Për menaxhimin e mbeturinave (Ndryshohet/Plotësohet nga Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-060 për mbeturina).
- Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma: Për limitet akustike në zona të banuara.
- Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës: Për ruajtjen e biodiversitetit

Udhëzimet Administrative (UA):

- UA Nr. 07/2021: Për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër.
- UA Nr. 08/2009: Për vlerat kufitare të zhurmës.
- UA Nr. 04/2025: Për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore, praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit
- UA Nr. 04/2025 për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore , praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit

10.3. Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik përfshin të gjitha planet, vizatimet, specifikimet dhe udhëzimet e nevojshme për zbatimin e projektit të zgjerimit të zonës së eksploatimit të bazalteve. Ai përfshin:

- Plan i detajuar i lokacionit dhe i frontit të punës;
- Skicat dhe planimetria e zonës së eksploatimit dhe rrugëve të brendshme;
- Specifikimet teknike për përdorimin e makinerive dhe pajisjeve minerare;
- Procedurat për sigurinë në punë dhe masat për mbrojtjen e mjedisit;
- Udhëzimet për kontrollin e pluhurit, zhurmës, vibrimeve dhe ujërave të ndotura;
- Planet për situata emergjente dhe masat për reagim në raste aksidentesh.

Ky dokumentacion shërben si bazë për zbatimin e kontrolluar dhe të sigurt të projektit, duke siguruar përputhshmëri me standardet teknike dhe ligjore.

11. BURIMET E TË DHËNAVE

11.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- TE DHËNAT NGA INVESTITORI
- [Gjakovë to 42.3263434, 20.4013178 - Google Maps](#)
- [Kosovo Geoportal](#)
- [Plani-Zhvillimor-Komunal-2022-2030_compressed-1.pdf](#)
- [LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS](#)
- [UDHËZIM ADMINISTRATIV \(MMPHI\) NR.04/2025 PËR PËMBAJTJEN, METODOLOGJINË DHE PËRPUTHSHMËRINË E RAPORTIT ME KËRKESAT LIGJORE, PRAKTIKAT E ZBATUESHME DHE ASPEKTET E TJERA TEKNIKE TË RAPORTIT](#)

12. SHTOJCA

- Raporti i VNM-së i nënshkruar nga aplikuesi dhe personi fizik apo juridik i pajisur me licencë nga Ministria për hartimin e raporteve të VNM-së, me një (1) kopje në formë të shkruar dhe një (1) kopje në formë elektronike.
- Dëshmia e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor.
- Vlera investive e projektit në formë tabelare.
- Certifikata e regjistrimit të biznesit.
- Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme.
- Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref.
- Plani i rilevimit të terrenit nga gjeodeti i licencuar, si dhe kopja e licencës së gjeodetit.
- Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, në rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e aplikuesit.
- Liceca e KPMM-së.
- Pëlqimi mjedisor paraprak
- Pëlqimi i Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftim/informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartës Zonale dhe kushteve ndërtimore.
- Licenca valide e personit fizik ose juridik, e lëshuar nga Ministria.

13. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E INFORMACIONIT

13.1. Hyrje

Ky raport përgatitet për zgjerimin e zonës së eksploatimit të bazalteve nga kompania “Karakushi” SH.P.K., në fshatin Zhub, Komuna e Gjakovës, në parcelën kadastrale P-70705033-00426-0. Aktiviteti zhvillohet në një zonë me karakter minerar dhe përfaqëson vazhdim të veprimtarisë ekzistuese të kompanisë, me qëllim rritjen e kapacitetit të nxjerrjes së materialit bazaltik për nevojat e tregut. Qëllimi është të vlerësohen ndikimet e mundshme në mjedis dhe të propozohet menaxhim i duhur për aktivitetin minerar, duke siguruar vazhdimësinë e furnizimit me material bazaltik për tregun dhe zhvillimin ekonomik lokal.

13.2. Përshkrimi i Projektit

Projekti përfshin minimin sipërfaqësor të masës shkëmbore bazaltike, ngarkimin në kamionë dhe transportin drejt separacionit të kompanisë, pa përfshirë përpunim industrial në lokacion. Zgjerimi i zonës shtrihet pranë infrastrukturës ekzistuese dhe nuk kërkon ndërtimin e kampeve apo objekteve të përhershme për punëtorët.

Zona e zgjerimit shtrihet në një sipërfaqe prej 5.90 ha. Nga aspekti i vendndodhjes, projekti ndodhet jashtë qendrave të banuara, në një distancë mbi 1 kilometër nga vendbanimet më të afërta, çka ndikon në uljen e ekspozimit të popullsisë ndaj efekteve të mundshme të aktivitetit. Lokacioni nuk ndodhet brenda zonave të mbrojtura natyrore, nuk janë identifikuar objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike në afërsi të drejtpërdrejtë dhe nuk ka burime ujore sipërfaqësore pranë zonës së projektit. Gjithashtu, zona e eksploatimit ndodhet ngjit me separacionin e kompanisë, me të cilin ka lidhje funksionale për transportin e materialit të nxjerrë. Operimi do të realizohet me makineri minerare dhe mjete plasëse, duke respektuar masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

13.3. Ndikimet kryesore mjedisore dhe masat mbrojtëse

Ndikimet e mundshme lidhen kryesisht me:

1. Pluhuri

- **Ndikimi:** Gjenerohet gjatë minimit, ngarkimit dhe transportit të bazaltit, duke ndikuar në cilësinë e ajrit dhe mundësisht në shëndetin e punëtorëve.
- **Masat mbrojtëse:** Përdorimi i sistemeve të lagjes në frontet e punës dhe rrugët e transportit; monitorimi i vazhdueshëm i pluhurit; përdorimi i filtrave në zonat më të ndjeshme.

2. Zhurma dhe vibrimet

- **Ndikimi:** Shkaktohen nga shpërthimet e kontrolluara dhe makineritë e rënda, duke ndikuar në ambientin përreth dhe në komoditetin e komunitetit.
- **Masat mbrojtëse:** Përdorimi i shpërthimeve të kontrolluara; teknologji për zvogëlimin e zhurmës dhe vibrimeve; kufizim i aktivitetit në orare të përcaktuara.

3. Ndryshimi i relievit dhe degradimi i tokës

- **Ndikimi:** Eksploatimi i bazaltit ndryshon konfiguracionin e terrenit dhe largon shtresën sipërfaqësore të tokës.
- **Masat mbrojtëse:** Planifikim i niveleve të minimimit; rehabilitimi progresiv i zonës; rikthimi i vegjetacionit dhe stabilizimi i skarpave.

4. Ndikimet indirekte në biodiversitet

- **Ndikimi:** Shkëmbimi i habitatit gjatë minimimit mund të prekë florën dhe faunën lokale.
- **Masat mbrojtëse:** Restaurimi i habitatit pas përfundimit të minimimit; rikthimi i vegjetacionit dhe masat për ruajtjen e ekosistemit.

Këto masa mbrojtëse janë projektuar për të siguruar që aktiviteti i zgjerimit të eksploatimit të bazalteve të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar dhe të qëndrueshme, duke minimizuar ndikimet negative në mjedis.

13.4. Përfitimet socio-ekonomike

Projekti i zgjerimit të zonës së eksploatimit të bazalteve ofron një seri përfitimesh socio-ekonomike për komunitetin dhe rajonin. Ai krijon vende pune për personelin e trajnuar dhe të licencuar, duke përfshirë punëtorët në minimin, ngarkimin, transportin dhe menaxhimin e zonës së eksploatimit. Bazalti i nxjerrë do të furnizojë material ndërtimi për kompanitë lokale të ndërtimit dhe projektet infrastrukturore, duke mbështetur zhvillimin e industrisë së zonës. Aktiviteti minerar gjithashtu kontribuon në rritjen e aktivitetit ekonomik në komunën e Gjakovës përmes taksave, shpenzimeve operative të kompanisë dhe zhvillimit të infrastrukturës së zonës. Projekti përmirëson aftësitë profesionale të punëtorëve dhe menaxherëve, duke rritur standardet e operimit dhe sigurinë në punë, si dhe siguron vazhdimësi në furnizimin me bazalt për nevojat ndërtimore, duke reduktuar varësinë nga importet dhe duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm lokal. Në këtë mënyrë, realizimi i projektit ka një ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë në komunitetin lokal dhe zhvillimin ekonomik të rajonit.

13.5. Përfundimi

Zgjerimi i zonës së eksploatimit të bazalteve nga kompania “Karakushi” SH.P.K. ofron mundësinë për shfrytëzim të qëndrueshëm të rezervave minerare në zonën e Zhubit, Komuna e Gjakovës, duke rritur kapacitetin e prodhimit dhe siguruar furnizim të vazhdueshëm me bazalt për nevojat e ndërtimit dhe industrisë lokale. Projekti ka përfitime të rëndësishme socio-ekonomike, përfshirë krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e aftësive profesionale të punëtorëve dhe menaxherëve, si dhe rritjen e aktivitetit ekonomik në komunitet përmes kontributit në taksa dhe shpenzimeve operative.

Nga ana mjedisore, projekti është planifikuar në mënyrë që të minimizojë ndikimet negative. Masat mbrojtëse përfshijnë kontrollin e pluhurit dhe zhurmës, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe të mbetjeve minerare, si dhe rehabilitimin progresiv të zonës së eksploatimit pas përfundimit të operimeve. Këto masa sigurojnë që habitatet natyrore të rikuperohen dhe ekosistemi lokal të ruhet sa më mirë të jetë e mundur.

Në përgjithësi, projekti zhvillohet në përputhje me standardet ligjore dhe teknike për mbrojtjen e mjedisit, duke garantuar një ekuilibër mes zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së mjedisit. Implementimi i planifikimit të kujdesshëm dhe masave mbrojtëse siguron që projekti të jetë i qëndrueshëm, i sigurt dhe me ndikim pozitiv afatgjatë për komunitetin dhe rajonin përreth.